

AKT THEMELIMI I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“GJIROKASTRA SOLAR ”

Ne Gjirokaster, sot me date 12-04-2018 , me vullnetin tone te lire dhe bazuar ne ligjin 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare , ne te nenshkruarit :

- Taulant Qëndro I biri I Ismetit , i datelindjes 20/05/1973 banues ne Gjirokaster , mbajtes i kartes se identitetit H30520185V
- Eno Veshi I biri I Pashkos , i datelindjes 17/05/1982 banues ne Tirane , mbajtes i kartes se identitetit I205170720

Vendosem :

NENI 1

Te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “GJIROKASTRA SOLAR ” . Shoqeria eshte e formes “ Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar” SH.P.K.

NENI 2

Objekti I veprimtarise te shoqerise do te jete :

Veprimtari ekonomiko-juridike ne fushen e energjitikes, duke percaktuar, por pa kufizuar veprimet e papermendura: krijimi i sistemeve elektroenergjitike, prodhim. import, eksport te energjise elektrike. me te gjitha format qe njeh teknologjia, duke permendur Panelet diellore, mullinje e eres, ndertim i Hidrocentraleve, mbi burimet hidrike te lejuara nga organet kompetente, ndertimi i liqeneve artificiale, mbi basene ujore, me qellim prodhim dhe shit-blerje

energjië. Termocentraleve me lende të djegshme, me lende berthamore. të lejuara nga ligji i kohës. Marrja e burimeve hidrike me koncesion, me qera ose blerjeve të territoriteve ku ndodhen ato, sipas lejeve të organeve kompetente, shit-blerjen e energjië elektrike tek operatorët lokal apo ndërkombëtar, sipas legjisllacionit dhe lejeve të organeve kompetente Nderim, projektim. zbatim të të gjitha linjave elektrike. interkonjeksionit për përcjelljen e energjië elektrike. Prodhimin vendas dhe shitjen/shkëmbimin e energjië elektrike, për të siguruar furnizimin e qendrueshëm dhe me kosto të ulët për klientet tarifo paralelisht me venien në punë të burimeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Si dhe të kryejë/krijojë/veprojë për realizuar të gjitha veprimet juridike, si pas përkufizimeve ligjore, të përcaktuara në ligjin për energjië elektrike, si vijon: "Sistemi elektro-energjetik" është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centrat e prodhimit të energjië elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet shpërndarëse, për transmetimin dhe shpërndarjen e energjië elektrike të konsumatorit. "Prodhim i energjië elektrike" është prodhimi i energjië elektrike nëpërmjet transformimit të burimeve të ndryshme energjetike nga një shoqëri prodhimi. "Shoqëri prodhuese" është një person i licencuar për të kryer veprimtarinë e prodhimit të energjië elektrike. "Prodhues i pavarur" është prodhuesi që nuk kryen funksionet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjië elektrike në sistemin elektro-energjetik. "Prodhues i privilegjuar" është prodhuesi që përmbush kriteret e parashikuara në nenin 39 dhe që përfiton një status të privilegjuar. "Vetëprodhues" është personi që prodhon energji elektrike, kryesisht për përdorim vetjak. "Burim zëvendësues" është një burim i dytë i furnizimit me energji elektrike, i palidhur me sistemin elektro-energjetik. "Bashkëprodhim" është prodhimi i kombinuar i energjiëve të dobishme elektrike dhe termike, i cili siguron një kursim të konsiderueshëm të energjië, krahasuar me prodhimin e ndarë. "Transmetim" është transporti i energjië elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar. "Sistem transmetimi" është sistem linjash, strukturash mbështetëse dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese, të përdorura për transmetimin e energjië elektrike. "Shoqëri transmetimi" ose "Operatori i sistemit të transmetimit" është person i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjië elektrike dhe të dispeçerimit. "Dispeçerim" është axhustimi ose rregullimi i prodhimit të energjië elektrike. sipas kërkesave të konsumit në nivel kombëtar. "Kodi i Funksionimit të Rrjetit" është teresia e rregullave teknike që rregullojnë funksionimin e sistemit të transmetimit. "Shpërndarje" është transpoili i energjië elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët. duke pasur parasysh, "Shoqëri shpërndarëse" është person i licencuar për të kryer shpërndarjen e energjië elektrike në një zonë të caktuar. "Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes" është teresia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorit. "Parametra standarde" janë vlerat e nivelit të tensionit dhe të frekuencës së energjië elektrike të furnizuar për konsumatorit, të përcaktuara në rregulloret e shfrytëzimit të sistemit elektro-energjetik të miratuara nga ERE-ja. Hyrja e paleve të treta" është e drejta e ligjshme e klienteve të kualifikuar dhe e furnizuesve për të përdorur rrjetet e transmetimit e të shpërndarjes. "Furnizim" është çuarja dhe/ose shitja e energjië elektrike klientit. "Furnizues i kualifikuar" është personi i licencuar për të furnizuar një ose më shumë kliente të kualifikuar. "Klient i kualifikuar" është klienti që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake. furnizuesin e energjië elektrike. "Klient i mandatuar ose jo i kualifikuar" është klienti i ndryshëm nga ai i kualifikuar i cili furnizohet nga shoqëria shpërndarëse, e pajisur me licencë për territorin ku ndodhet vendi i konsumit të energjië elektrike. "Treg i energjië elektrike" është shkëmbimi i kërkesave dhe ofertave për blerje dhe shitje ose furnizim të energjië elektrike, etj.



NENI 3

Afati I shoqerise :

- Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe te pa caktuar kohore .
- Por ky afat mund te ndryshoje me vullnetin e lire te ortakeve.

NENI 4

Selia e shoqerise :

Gjirokaster, lagjja 18 Shtatori, rruga Studenti objekti nr. 13

NENI 5

Kapitali I shoqerise :

- Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 10 000 000 leke (dhjete milion leke) .
- Kapitali I shoqerise do te zoterohet :
- Taulant Qëndro 50 % te kapitalit ose 1 kuote te barabarte me 5 000 000 leke
- Eno Veshi 50 % te kapitalit ose 1 kuote te barabarte me 5 000 000 leke
-
- Shoqeria mund ta zmadhoje ose ta zvogeloje kapitalin e saj .



NENI 6

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transmetueshme ne rruge trashegimie apo brenda familjes .

NENI 7

Administrimi :

- Organi me I larte I shoqerise eshte asambleja e pergjitheshme e ortakeve .
- Menyra e thirrjes se asamblese se shoqerise do te percaktohet ne statutin e shoqerise .

NENI 8

Administratori :

- Administrator I shoqerise do te jete Taulant Qëndro .
- Afati administratorit do te jete 5 (pese) vjet .
- Afati I administratorit mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve .

NENI 9

Per arritjen e qellimeve te veta shoqeria mund te punesoje punonjes te tjere te ndryshem , duke respektuar legjislacionin ne fuqi .



NENI 10

Fitimi qe do te rezultoje nga veprimtaria e shoqerise I takon ortakeve te saj . Shoqeria nuk pergjigjet per humbjen e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise . Mosmarreshjet qe mund te lindin mes paleve brenda dhe jashte shoqerise , me persona fizike e juridike zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare

ORTAKU THEMELUES

Taulant Qëndro

Eno Veshi



